



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-10981/20 datë: 01.07.2020



Npi – 01/161 datë: 06.07.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 06.07.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VI- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 06.07.2020 (e hënë) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbresha Sylja, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Nënkryetari, z.Rahman Jakupi; Zyrtari për barazi gjinore z.Reshat Gashi; Zyrtari për Informim z.Lulzim Sahiti; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Raport për Covid-19,
2. Draft-Rregullorja Komunale për Mbrojtjen e Fëmijës,
3. Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë,
4. Draft-Plani i Punës të KKSBB-ë për vitin 2020-21, (pas diskutimit publik)
5. Draft-Programi Komunal Trevjeçar për banim 2020-2022, (pas diskutimit publik)
6. Shqyrtimi i Kërkesave,
7. **Deklaratë, për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së (Pikë Shtesë)**

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, propozoj që në rendin e ditës ta fusim edhe një pikë shtesë si pikë e parë e rendit të ditës: “Deklaratë, për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së”. Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës.

z.Perparim Ramusa; Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës, edhe me pikën shtesë të propozuar nga Kryesuesja e Kuvendit.

znj.Zarife Rexhaj; Përshëndetje, edhe unë pajtohem me pikat e rendit të ditës.

z.Naim Zejna; Përshëndetje, pajtohem me pikat e rendit të ditës, pyetje për sa i përket deklaratës, se a është tekst i unifikuar apo duhet që ne ta përpilojmë tekstin e saj.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht aprovoi rendin e ditës, me pikën e 7 shtesë, “Deklaratë, për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së”**

Pika 1
Raport për Covid-19

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Nënkyetari.

Nënkyetari, z. Rrahman Jakupi; Përshëndetje, sa i përket Pandemisë KOVID19, është formuar Shtabi Emergjent në komunën e Shtimes. Shtabi Emergjent ka ndihmuar mjaft shumë në përballimin e gjendjes, sikurse është shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike. Ju kemi ofruar pako të gjitha familjeve që kanë qenë të përfshira me KOVID19, por ka pas edhe familje të cilat nuk ka pas nevojë për ndihmë. Nga buxheti komunal janë shpërndarë 300 Pako. Unë nuk do ta zgjati shumë, meqenëse raportin e keni në formë të shkruar dhe e keni marrë me kohë. Ne i falënderojmë të gjithë donatorët dhe ata që kontribuuan që ta përballojmë këtë gjendje, të pandemisë e cila ende nuk ka përfunduar, (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje jemi këtu për tu përgjigjur.

znj. Zarife Rexhaj; E falënderoj Nënkyetarin për raportin. E falënderoj po ashtu edhe stafin e QKMF-së për punën dhe angazhimin e tyre, gjatë kësaj pandemie. Kam një pyetje për Nënkyetarin se a keni ndonjë plan për mos përhapjen e pandemisë?

z. Perparim Ramusa; E falënderoj Nënkyetarin për raportin. Një falënderim i veçantë dhe mirënjohje për stafin mjekësor në QKMF-ë, Mjekët dhe Infermierët që në çdo moment kanë qenë të gatshëm të japin ndihmën mjekësore për këta pacientë. Po ashtu i falënderojmë edhe donatorët dhe gjithë ata që kontribuuan për parandalimin e kësaj sëmundje ngjithëse. Këta 6 pacientë me Kovid19 në komunën tonë uroj që të shërohen sa më shpejt.

znj. Adelina Beqaj; E falënderoj Nënkyetarin për raportin e detajuar. I falënderoj Mjekët dhe Infermierët, por edhe punëtorët e Qendrës për Punë Sociale, që u kanë ndihmuar familjeve në nevojë, edhe përkundër rrezikut që kanë qenë të ekspozuar, po e shoh që këta nuk po falënderohen në mënyrën e duhur që e meritojnë.

z. Ruzhdi Jashari; Përshëndetje, unë e kam vetëm një pyetje lidhur me pandeminë KOVID19, lidhur me furnizimin me pajisje mbrojtëse që është bërë, a është bërë furnizimi me ofertë të hapur apo është bërë me procedurë të negociuar?

Nënkyetari, z. Rrahman Jakupi; Kemi pas edhe vullnetarë që na kanë ndihmuar e të cilët i falënderojmë. QKMF-ja ka qenë normalisht më e ngarkuara dhe për këtë e falënderojmë gjithë stafin. I falënderojmë edhe ata të cilët shpi për shpi kanë shpërndarë pako. Janë dy ekipe të themeluara që fillimisht i konstatojnë të prekurit, njoftohet ai dhe kërkohet prej tij që ti jep të gjitha të dhënat e tij dhe për qarkullimin e tij. Dhe është ekipi tjetër që i ndihmon të prekurve me virusin Korona. Unë po e marr pyetjen e Ruzhdiut dhe do ta përcjelli në zyrën e prokurimit, që ta shohim saktë procedurën, sepse Qeveria e Republikës së Kosovës e ka sqaruar saktë procedurën e blerjeve.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e raportit për Pandeminë "COVID-19".**

Pika 2

Draft-Rregullorja Komunale për Mbrojtjen e Fëmijës

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Nënkyetari.

Nënkyetari, z. Rrahman Jakupi; Ne si ekzekutiv kemi përgatitur një Draft-Rregullore për avancimin e të drejtave të fëmijëve. Unë propozoj që ti rekomandoni Kuvendit që ta nxjerrë në diskutim publik. Materialin për këtë pikë e keni marrë me kohë dhe besoj se e keni lexuar, i mirëpres pyetjet e juaja, (shih dokumentin).

znj. Zarife Rexhaj; E falënderoj Nënkyetarin për prezantimin e këtij drafti, por unë kam një pyetje, se a keni statistika, sa prej fëmijëve nuk janë duke e ndjekur shkollimin fillor, sidomos të komunitetit pakicë?

z. Perparim Ramusa; E falënderoj Nënkyetarin për Draft rregulloren për fëmijë. Pajtohem që të shkojë në diskutim publik.

z.Naim Zejna; Edhe unë pajtohem që ky draft të shkojë në diskutim publik dhe ta bëjmë më gjithëpërfshirëse.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik për 15 ditë, Draft-Rregulloren Komunale për Mbrojtjen e Fëmijës.**

Pika 3

Propozim-Vendim për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Agime Roshaj.

znj.Agime Roshaj, drejtoresh e DKA; Pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, prezantoi para Kuvendit, Propozim-Vendimin për zgjedhjen e dy anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë. Propozim-Vendimin e keni marrë me kohë, tani i mirpres pyetjet nga ana juaj, dhe po ashtu pres që ta miratoni këtë Propozim-Vendim, (shih dokumentin).

z.Perparim Ramusa; Unë propozoj që për këtë pikë vetëm në Kuvend të Vendosim.

z.Ruzhdi Jashari; Unë propozoj që të vazhdojnë punën si Komision të njëjtit anëtarë.

znj.Arbresha Sylaj; Përshëndetje, nëse nuk kemi emra atëherë i rekomandojmë Kuvendit, që të vazhdojnë Komisioni me emrat e njëjtë.

z.Naim Zejna; Unë pajtohem me formatin e Komisionit që të ketë 2 anëtarë nga Kuvendi 1 pozita edhe një opozita. Por unë jam që të shkojmë me propozime të reja, kështu që unë e propozoj znj.Zarife Rexhaj.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Unë jam e mendimit që me propozime të vazhdojmë në Kuvend, sepse aty i kemi të gjitha subjektet politike, që janë të përfaqësuara.

z.Perparim Ramusa; Unë propozoj që opozita të koordinohet me kandidatin e tyre, sepse për ne është krejt njëjtë si VV si LDK.

z.Naim Zejna; Subjektet politike janë të ndara, por nëse është shumica, atëherë edhe ne pajtohemi që të shkojmë në Kuvend.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" i rekomandon Kuvendit që të vendos për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për ndarjen e bursave për Studentë.**

Pika 4

Draft-Plani i Punës të KKSB-ë për vitin 2020-21, (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Nënkrjetarit.

Nënkrjetari, z.Rrahman Jakupi; Kuvendi i Komunës ka marrë vendim për ta quar në diskutim publik, Draft-Planin e Punës së KKSB-ë për vitin 2020-21. Diskutimin publik e kemi mbajtur por nuk kemi qenë të kënaqur me pjesëmarrjen, kanë marrë pjesë vetëm 5 por diskutimet kanë qenë të frytshme dhe janë nxjerrë 8 rekomandime, me të cilat ju jeni njoftuar me kohë. Në Plan janë përfshirë të gjitha fushat e sigurisë. Unë nuk do ta zgjati me leximin e këtyre rekomandimeve por i mirpres pyetjet e juaja, (Shih dokumentin).

z.Ruzhdi Jashari; Aspekti i sigurisë është shumë i rëndësishëm, sepse në të përfshihen shumë fusha të jetës. Megjithatë konsiderojmë se është me rëndësi, ne do ta analizojmë pak më thuktë për mbledhjen e Kuvendit.

z.Naim Zejna; Ne sigurisht që do të diskutojmë në Kuvend, por unë kam një vërejtje konkrete, sepse Kuvendi është pak i përfaqësuar në KKSB-ë. Ne kërkojmë që aty të jetë edhe një përfaqësues nga opozita.

z.Perparim Ramusa; Unë mendoj se Kryesuesja na përfaqëson të gjithëve, kështu që nëse ka kërkesa atëherë do të kërkojnë të gjitha Partitë.

Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Ekziston një Udhëzim Administrativ i cili saktë e përcakton strukturën e përfaqësimit në KKSB-ë.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Draft-Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2020-2021.**

Pika 5

Draft-Programi Komunal Trevjeçar për banim 2020-2022, (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Nënkryetarit.

Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Fillimisht dua që ta falënderoj komisionin për hartimin e këtijë programi komunal për banim 2020-2022. Sipas vendimit të Kuvendit, është mbajtur diskutimi publik, dhe propozimet e dhëna janë inkorporuar në dokument. Meqenëse jemi në prag të aprovimit të buxhetit unë propozoj që ju si Kuvend ta trajtoni mirë aspektin financiar të këtijë programi.

znj.Adelina Beqaj; Është një dokument shumë i mirë, për sa i përket aspektit të strehimit të nevojtarëve që kanë më së shumti nevojë për banim. Tash që po punoj në Qendrën për Punë Sociale, po e shoh nga afër që ka shumë nevojë për banim. Në mesin e këtyre nevojtarëve kemi edhe rastet e nënave vetushqyese që kanë nevojë për banim. Ka pas raste edhe të atyre që u është djegur shtëpia dhe nuk kanë pas se ku të strehohen, dhe ne nuk kemi pas mundësi që tu dalim në ndihmë. Për këtë arsye unë jam që në bixhet të futet edhe një vijë buxhetore për këtë Program për banim.

z.Ruzhdi Jashari; Është mirë që ta kemi një Rregullore, të tillë të mirë. E përkrahu diskutimin e znj.Beqaj, për arsye se ajo e din mirë nevojën për banim meqenëse punon në Qendrën për Punë Sociale. Unë thjeshtë jamë për një rregullore që do ta rregullonte pak a shumë këtë fushë, e jo kjo qështje me mbetur në duart e një personi.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Draft-Programit komunal trevjeçar për banim për periudhën 2020-2022.**

Pika 6

Shqyrtimi i Kërkesave

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Lexoi, Kërkesat si vijon:

1. z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, i përfaqësuar nga Avokati z.Kemajl Ademaj me zyrën e Avokatisë në Ferizaj Rr."Hamëz Jashari" p.n. Kërkesa Nr.01-070/05-1225/20 datë:16.01.2020, i cili në emër të z.Bahri Rexhaj nga fshati Petrovë, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, këmbimin e pronës së pa luajtshme që i është marrë nga Komuna me rastin e hapjes së rrugës Petrovë-Llanisht. (Për detaje, shih Listën e Kërkesave Npi – 01/136 datë: 01.07.2020). Në vazhdim Kryesuesja hapi diskutimin për këtë kërkesë.

znj.Adelina Beqaj; Unë kam një pyetje për administratën, ka ardhur edhe një kërkesë tjetër, pse nuk është në Kuvend? Zyrtari Ligjor, z.Lulzim Muharremi e din që kjo kërkesë është në kontest gjyqësor.

z.Ruzhdi Jashari; Kjo kërkesë nuk është se ka ardhur sefte. Ka pasur "Për" dhe ka pasur "Kundër". Ka pasur që kanë thënë për shpronsim dhe për kompenzim. Ne duhet të kemi parime të qarta. Komuna e ka ditur që është duke nxënë pronën e huaj. Duhet të dihet qartë se nuk ndërtohet rruga pa e rregulluar dokumentacionin komplet. Nëpër fushata turreni me bërë rrugë pa kurrfar letrash, e pastaj më vonë hajde ti rregullojmë, kështu për pak metra katror shkojnë me mijëra euro. Unë jam kundër kësaj qasje. Sa i përket kësaj kërkesë unë jam që le të shkojë në Gjykatën e Apelit.

z.Lulzim Muharremi, Zyrtar Ligjor; Përsëendetje, Kjo pronë që nga viti 1988 është si rrugë, mirëpo ka mbetur në emër të Bedri Rexhaj, dhe e ka të drejtën e kompensimit. Bedri Rexhaj ka të

uzurpuar tokë komunale te shtëpia e tijë (Galanit), tani kërkesa është bërë për ta kompenzuar me tokë. Kuvendi duhet të vendosë nëse don ta bëjë kompensimin ose jo.

z.Naim Zejna; Është kërkesë, vërtetë e vjetër. Ky pra ka kërkuar nga Kuvendi që ti kompenzohet në mënyrë të barazvlefshme (Ekuivalente), ajo pronë me pronën afër shtëpisë së tijë. Unë nuk po e pranoj si akt të kryer dhe ne tani ta legjitimojmë. Ne duhet ta shohim se ku e kemi dobinë, kështu që unë propozoj që kjo kërkesë të aprovohet dhe mos ti lihet Gjykatës.

z.Perparim Ramusa; Kësaj kërkesë nuk është nevoja me i dhënë konotacion politik, sepse prona është pa rrugë. Unë jam që ta ndërrojmë, por që kjo të jetë në mënyrë proporcionale të çmimi.

znj.Arbesha Sylja; Unë po kërkoj që të na ofrohen hartat, me qëllim që ne ta dimë sakt vendodhjen dhe sasinë e sipërfaqeve në të dy pronat.

znj.Zarife Rexhaj; Unë vërtetë nuk e kam të qartë se ku qëndron problemi i këmbimit të kësaj prone.

z.Lulzim Muharremi, Zyrtyar Ligjor; Gjeodetët, munden me i bërë matjet e sakta, dhe vlerësimin e pronave, dhe pastaj me i sjellë në Kuvend për shqyrtim.

znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Përshëndetje, unë desha vetëm të sqaroj se Vlerësimin e Pronave e bënë komisioni i Ministrisë, ose Gjykata.

znj.Adelina Beqaj; Banorët nuk janë të interesuar që të rrënojnë shtëpitë e askujt.

znj.Arbesha Sylja; Unë kërkoj që kjo kërkesë të shtyhet për Kuvend dhe të sillen komplet hartat, me qëllim që ta dimë sakt se qka po vendoset.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 2 vota "Abstenim" vendosi t'i rekomandoj Kuvendit, që kërkesa e z.Bahri Rexhaj - Petrovë të shtyhet deri në mbledhjen e rregullt, me arsyetimin që të merren më shumë informata.**

2. z.Sali Beqa - Petrovë, Kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 datë:09.03.2020, i cili nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka kërkuar që të gjej një zgjidhje për pronën që e kemi në Davidovc me Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, me sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, pasi që nga viti 2007 nuk po mundemi, që ta shfrytëzojmë për shkak të pengesave nga banorët e fshatit Davidovc. Në vazhdim Kryesuesja tha se po dua të ju informoj se Kryetari po përpiqet të bëjë një takim për këtë çështje me Salih Beqa dhe me banorët e fshatit Davidovc, dhe nga ky takim pastaj do ta shohim se si po vendoset mes tyre. Hapi diskutimin për këtë kërkesë.

znj.Adelina Beqaj; Kjo kërkesë është e kahershme, të cilës ne duhet ti bëjmë një zgjidhje, me një kompenzim që ai po e kërkon.

z.Perparim Ramusa; Nëse na lejohet, unë jam që ti bëjmë një rekomandim ekzekutiv, psh. që Kryetari të gjej një zgjidhje mbi bazën e kompromisit.

z.Naim Zejna; Ne si LDK-ë kemi dhënë disa rekomandime lidhur me këtë pronë të Salih Beqaj. Është e saktë që ai është pronari i asaj toke, dhe ne duhet ti japim një zgjidhje alternative. Këtë çështje ne duhet ta vendosim një herë e përgjithmonë.

z.Perparim Ramusa; Unë po kërkoj që në takimet e Kryetarit të jetë prezent edhe Kryesuesja e Kuvendit.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi që nuk ka rekomandim konkret për Kuvendin lidhur me kërkesën e Sali Beqa – Petrovë, por kërkon nga Ekzekutivi, duke përfshirë edhe Kryesuesen e Kuvendit, që të bisedojnë me palën dhe banorët e fshatit Davidovc, për ta gjetur një zgjidhje të pranueshme.**

3. z.Adem ramadani, (Kryetar i fshatit Raçak), Ankesë Nr.01-070/05-9498/20 datë:16.06.2020, i cili në emër të Kryesisë së fshatit Raçak, ka shprehur shqetësimet e banorëve të fshatit, lidhur me dhënien e pëlqimit nga Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, për operimin, minimin, shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit natyror nga një Kompani e gurthyesve në vendin e quajtur

“Reze” në fshatin Raçak, Kryesuesja lexoi kërkesën dhe rekomandimin e DPUKGJ-së, dhe hapi diskutimin për këtë kërkesë.

znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Siç e keni parë në dokumentacion, ne e kemi lëshuar një pëlqim i cili nuk është dokument përfundimtar, ky pëlqim është dokument i cili tregon se aty nuk ka pengesa Ligjore dhe nuk është në kundërshtim me Planin Zhvillimor Komunal. Kuvendi është organ i cili mundet me vendosë nëse nuk donë me dhënë pëlqime të tilla. Ne kemi dhënë dokument shtesë ku tregon parametrat që janë plotësuar.

znj.Adelina Beqaj; Faleminderit për sqarimet nga ana e drejtorisë. Unë kam njohuri për këtë kërkesë, 70% e banorëve janë kundër një kërkesë të tillë. Unë sinjorisht mendoj se është e tepërt hapja e një gurore tjetër atje, mendoj se ato dyja që janë aty janë boll.

z.Ruzhdi Jashari; Pëlqim ka dhënë Komuna, por kjo duhet me i respektuar disa rregulla, e që duhet me përcjellë dhe mbikëqyrë zbatimin e vendimeve të Kuvendit, dhe akteve të tjera. Aty siguria e nxënësve është në pikëpyetje. Pastaj, Reqaku e ka një vendim që është zonë me interes të veçantë, vetëm duhet me i hallakatë dokumentet. Te Agjensioni për mbrojtjen e monumenteve ke mundur ti drejtoresh me siguruar një konfirmim për sa i përket mbrojtjes së Kompleksit të Masakrës së Reqakut. për këtë arsye unë jam kategorik “Kundër”.

z.Naim Zejna; Është një problem i kamotshëm i guroreve, që Kuvendi ka kërkuar të bëhet një planifikim më i mirë për to. Edhe kjo firmë “Mineral Stone” sa më duket mua është kah vepron që dhjetëra vjet. Nuk jam i bindur plotësisht lidhur me rekomandimin e drejtorisë. Duhet të jemi më të kujdesshëm, kështu që unë kam dëshirë që me pas informata shtesë për këtë kërkesë.

z.Perparim Ramusa; Drejtoresha ishte shumë e qartë. Pronari i firmës po kryen hulumtime afër “Kodrës së Bebushit”, si vend i njohur ku ka ndodhur masakra e Reqakut, unë mendoj se ne duhet të kërkojmë sqarime për këtë te organet qendrore të Republikës së Kosovës.

z.Lulzim Sahiti, zyrtar për informim; Përsëritet, desha vetëm të sqaroj se kjo që po ndodhë nuk është te “Kodra e Bebushit” por te vendi i quajtur “Guri i Bagdashit” e që është një pikë strategjike, e cila duhet po ashtu të mbrohet.

znj.Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Reqaku nuk është zonë e mbrojtur, kjo është çështje e nivelit qendror.

z.Perparim Ramusa; Nëse na lejon Ligji, me gjithë dëshirë ne kishim filluar procedurat për ta shpallur Reqakun si zonë e mbrojtur.

Nënkryetari, z.Rrahman Jakupi; Po sqaroj se përveç kësaj janë edhe dy operator që punojnë atje edhe ato bëjnë pluhur dhe zhurmë. Unë jam që këtë operator me qar në Agjensionin për Minerale, dhe atje le të refuzohet. Unë mendoj se nëse i ndalet këtij atëherë me i ndalë edhe ato dy të tjerat.

z.Perparim Ramusa; Unë propozoj që të shtyhet sepse edhe ashtu nuk është shumë me urgjencë, dhe me qëllim që të kemi më shumë njohuri rreth kësaj.

z.Ruzhdi Jashari; Unë kërkoj që urgjentisht, Reqaku të shpallet zonë me interes të veçantë. Ndërsa sa i përket kërkesave duhet parimisht që të veprohet njëjtë për të gjitha.

z.Naim Zejna; Pajtohem parimisht me Përparimin, kështu që edhe unë propozoj që ta shtyjme për mbledhjen e radhës që të përgatitemi më mirë për një zgjidhje të qëndrueshme.

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 6 vota “Për” me 1 votë “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” vendosi t’i rekomandoj Kuvendit, që kërkesa e Adem Ramadanit - Raçak, të shtyhet deri në mbledhjen e radhës, me arsyetimin që të merren më shumë informata, dhe të sqarohet gjendja më mirë.**

Pika 7 (Pikë Shtesë)

Deklaratë, për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Lexoi propozim-deklaratën për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së. Në vazhdim hapi diskutimin për këtë pikë.

z. Ruzhdi Jashari; Kur është themeluar Gjykata Speciale, Lëvizja Vetëvendosje, ka qenë e vetme në kundërshtimin e sajë. Kjo tani me deklarata e protesta janë tepër të vonuara, kështu që vetë e keni votuar. E dimë që kemi kaluar nëpër situata shumë të rënda, por ju merak e keni pas vetveten. Me pas paditur Serbinë në Gjykatë për gjenocidin, masakrat e dhunën që e ka bërë në Kosovë, tani ndryshe ne do ti kishim punët. Tani për mendimin tim nuk mund të bëhet asgjë.

znj. Arbresha Sylaj; Në fakt nuk kam çka ti shtoj më shumë kësaj që u tha, plot ka pas delegat që i kanë thënë njëri tjetrit kriminel. Është votuar për themelimin e Gjykatës Speciale, për shkak se ka pasur presion që nëse nuk formohet atëherë atë do ta formojë Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Objektivisht duhet me qenë shumë naiv dhe i pa ditur që të besosh në fjalët kur thuhet se nuk po gjykohet UÇK-ja por individët. Ne do ta përkrahim dhe do ta votojmë këtë deklaratë.

z. Perparim Ramusa; Të falënderoj për këtë deklaratë, jemi kah bisedojmë për një aktakuzë të mundshme ndaj liderëve të UÇK-së. Unë shumë shkurt mendoj se duhet ti rekomandojmë Kuvendit për aprovim.

z. Naim Zejna; I dimë të gjitha kush çka ka bërë. Unë propozoj që te pika e pestë të inkorporohen edhe fjalët “edhe për të tjerët” që janë objekt i aktakuzës, e mos të paragjykojmë se kush mund të ketë aktakuzë.

z. Ruzhdi Jashari; Çështjet ndërmjet subjekteve politike unë nuk i përmenda. Patriotizmi është treguar kur ka qenë koha, e tash hapa hapa ne duhet me u treguar me dituri dhe drejtësi.


znj. Adelina Beqaj; Kam lexuar dhe dëgjuar mjaft shumë për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, dhe unë besoj plotësisht në pafajësinë e tyre, kështu që normalisht që do ta përkrahi dhe do ta votoj këtë deklaratë.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Konstatoi kuorumin prej 7 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i rekomandoj Kuvendit, aprovimin e Deklaratës për mbrojtjen e vlerave të luftës së UÇK-së.**

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj: Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi në ora 12.23h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

